



Pogradec, Maj 2020
RINIA PËR INTEGRIM AKTIVIZIM DHE SENSIBILIZIM
& BORDI RINOR KËSHILLIMOR

MONITORIMI I BASHKISË POGRADEC

NË LIDHJE ME MASAT E NDËRMARRA NË KUADËR TË PANDEMISË COVID – 19



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Suedi
Sverige

TABELA E PËRMBAJTJES

3 SHKURTIME

3 FALENDERIME

4 HYRJE

5 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

7 ANALIZË E GJETJEVE

Raportim bazuar në informacionet e Bashkisë Pogradec
Gjetje nga intervistat cilësore

15 SITUATA E BIZNESEVE

16 REKOMANDIME

17 ANEKSE

Vendimet e Këshillit Bashkiak

Pyetëtori që i është dërguar bashkisë

Ky raport është përgatitur nga organizata "Rinia Per Integrim Aktivizim dhe Sensibilizim" dhe Bordi Rinor Keshillimor, Pogradec në kuadër të projektit POP 2020 "Monitorimi i zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal" të mbështetur nga Olof Palme Centre International, përmes mbështetjes financiare të Qeverisë Suedeze. Përmbajtja është përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Qeverisë Suedeze ose të Olof Palme International Centre.

Shkurtime

| | |
|---------------|--|
| NE | Ndihmë Ekonomike |
| NJA | Njësi Administrative |
| URB | Zonat Urbane |
| RUR | Zonat Rurale |
| KMACP | Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë |
| KEMP | Asistencë për pa-aftësi për punë |
| Fëmijët me AK | Fëmijë me aftësi të kufizuar |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| PAK | Personat me aftësi të kufizuar |
| POP | Përballja e Ofertave Politike |
| MKR | Mekanizmi Kombëtar i Referimit |
| MSHMS | Ministria e Shëndetit dhe Mbrojtjes Sociale |

Falenderime

Për të hartuar këtë raport gjatë mbylljes së pazakontë për shkak të pandemisë COVID-19 bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë Bashkinë Pogradec, në veçanti Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, për përgjigjen e shpejtë dhe brenda afatit kohor si dhe Këshillin Bashkiak Pogradec, për vënien në dispozicion të vendimeve të marra gjatë pandemisë COVID-19. Falenderojmë veçanërisht qytetarët që pranuan ti përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) të cilët si ne po bëjnë një punë shumë të mirë pranë territoreve ku operojnë në ndihmë të komunitetit.

Gjithashtu dëshirojmë të falenderojmë Olof Palme International Center, për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohet ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Gjatë vitit 2019 organizatat e Rrjetit POP zbatuan projektin "Përballja e Ofertave Politike - 2019 (POP 2019)" në 9 bashki të vendit, Tiranë, Durrës, Kukës, Pukë, Vlorë, Fier, Kamëz, Pogradec, Shkodër. Përgjatë vitit 2019 u arrit që të nënshkruheshin Kontrata Sociale të hartuara bazuar në prioritetet e komunitetit midis kryetarëve të rinj të bashkive dhe përfaqësuesve të organizatave anëtare të POP që veprojnë në bashkitë e sipër përmendura.

Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe përçojë informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP 2019, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: "Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social". Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorës,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamez;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj "Shpresë", Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Pogradec.

Gjatë vitit 2020 projekti vijon me "*Monitorimin e zbatimit të kontratës sociale në nivel lokal.*" Gjatë fazës së parë të kësaj nisme POP synon që të llobojë dhe të advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve që janë nënshkruar në Kontratat Sociale për bashkitë: Tiranë, Kamëz, Durrës, Fier, Vlorë, Shkodër, Kukës, Pukë dhe Pogradec, gjithashtu synon përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje.

Por, mes situatës së krijuar nga COVID-19, anëtarët e rrjetit POP përshtatën aktivitetet për të ndjekur reagimin e pushtetit qendror e lokal si dhe problemet e komunitetit që këto organizata përfaqësojnë.

Gjatë muajve mars dhe prill 2020, organizatat patën si qëllim:

- Të monitorojnë Këshillat Bashkiakë dhe veprimtarinë e bashkive për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të fatkeqësisë natyrore për shkak të pandemisë;
- Të raportojnë gjetjet dhe rekomandimet;
- Të llobojnë dhe advokojnë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve sidomos në kuadër të Dimensionit Social, Transparencës dhe Llogaridhënies.

Metodologjia

Për të realizuar raportin, organizatat anëtare të POP u bazuan në metodat më poshtë.

1. Në çdo bashki u dërgua një letër-kërkesë për informacion. Përgjigjet e kësaj letre janë në pjesën e analizimit të gjetjeve
2. U realizuan disa intervista cilësore me banorë të njësive të ndryshme, të cilët kanë qenë pjesë e aktiviteteve të mëparëshme dhe kanë kontribuar në përcaktimin e prioritetëve të Kontratës Sociale.
3. U monitoruan takimet e ndryshme të përfaqësuesve të bashkisë përmes TV dhe medias sociale.
4. U monitoruan vendimet e keshillave bashkiakë në lidhje me masat e vetë bashkisë në lidhje me komunitetin në përgjithësi dhe me disa target grupe në veçanti, si dhe veprimtaria e anëtarëve të këshillave bashkiakë.

Përmbledhje Ekzekutive

Në bazë të monitorimit të Bashkisë Pogradec, të kryer nga organizata "Rinia Për Integrim Aktivizim dhe Sensibilizim" dhe Bordi Rinor Këshillimor Pogradec, më poshtë disa nga gjetjet.

Gjetje nga përgjigjet e Bashkisë dhe monitorimi i faqeve zyrtare:

- Bazuar në informacionet zyrtare dhe monitorimin e bëre nuk rezulton asnjë rast me COVID 19 në Pogradec, duke qenë kështu një nga zonat e gjelbra në Shqipëri.
- Gjatë muajve Shkurt dhe Mars 4498 familje kanë qenë përfitues të ndihmës ekonomike nga Bashkia Pogradec. Nga këto, 720 familje janë ndihmuar edhe me shërbime të tjera nga Bashkia.
- Jane 5031 persona që trajnohen me Kemp nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMACP) nga të cilat 2566 janë burra dhe 2465 gra. 169 persona nga kjo kategori janë mbështetur dhe me shërbime të tjera.
- Përgjatë muajit Mars dhe Prill janë raportuar tre raste dhune në familje, të treja nga gra.
- Sipas të dhënave zyrtare janë 5540 familje nga Komuniteti Rom & Egjiptian në Pogradec dhe në rrethinat e tij.
- Janë 7 persona me statusin e Jetimit në Bashkinë Pogradec prej të cilëve 5 janë burra dhe 2 gra.
- Janë vetem 2 raste të vajzave-nëna në Bashkinë Pogradec.
- Janë asistuar me shërbime të ndryshme 1512 pensionistë. Nga kjo kategori Bashkia Pogradec ka identifikuar rreth 128 pensionistë që jetojnë vetëm dhe që familjarët ju jetojnë jashtë. Nuk kemi informacion për ndarjen gjinore por sipas informacioneve nga Bashkia janë me projeksion më të madh të gjinisë mashkullore.
- Sipas monitorimit të faqes zyrtare të Bashkisë Pogradec në FB nga data 1 Prill deri më datë 30 Prill rezultoi që: nëpërmjet bashkëpunimit me organizata, fondacione dhe biznese të ndryshme, Bashkia Pogradec ka mundësuar pajisjen me pako ushqimore të 2675 familjeve nga zona dhe kategori të ndryshme të Pogradecit.

- Përmbatja e paketës ka qenë në varësi të donatorit dhe shpërndarja e tyre bëhet bazuar në sasi dhe në numrin e anëtarëve të familjes;
- Nga i njejtë burim (faqja zyrtare në FB) mësojmë që Bashkia Pogradec në bashkëpunim me biznese të ndryshme ka marrë përsipër furnizimin me 3 vakte të 55 shtetasve shqiptarë që janë të akomoduar tek Hotel "Euro Korça" në Pogradec për 14 ditë.
- Sipas të dhënave zyrtare nga Bashkia rezulton që për muajin Mars nr. i familjeve që i janë shpërndarë ndihma dhe i janë ofruar shërbime të ndryshme është 2593.
- Nuk ka ndarje gjinore për shumë nga të dhënat që morëm nga bashkia Pogradec. Kjo na pengon të analizojmë gjetjet nga pikëpamja gjinore.
- Ndarja gjinore pasqyrohet për nënkategoritë: a) Personat që trajtohen me Kemp b) Jetimë c) rastet e dhunës në familje.
- Nuk ka shtim të pagesave për personat me aftësi të kufizuar gjatë muajit Mars 2020.

Gjetje nga intervistat cilësore me qytetarë:

- Sipas intervistave në Gur të Kuq, ku ndodhen rreth 50 familje Rome & Egjiptiane, ato shprehen që janë ndihmuar me pako ushqimore nga OJF dhe kanë mbetur të kënaqur nga përmbatja.
- Gjithashtu nga intervista të tjera me qytetarët që kanë përfituar pako ato shprehen të kënaqur nga pako që kanë marrë nga Bashkia. (1 pako përmbante ushqimet bazë të shportës, 1 thes me miell, vaj, sheqer, kripë, makarona, oriz dhe detergjentë)
- Sipas intervistave me familjarët dhe personat me AK, rezulton që pagesa ka kaluar pa problem dhe nuk ka pasur as ulje as rritje të saj.
- Sipas intervistave me personat që përfitojnë nga ndihma ekonomike rezulton që ka pasur dyfishim të kësaj pagese për muajin Mars 2020.
- Sipas intervistave me qytetarët nuk ka pasur probleme në marrjen e pensionit dhe Bashkia ka venë në dispozicion një nr. tel (për çdo njësi administrative një person/ numër telefoni përgjegjës) për të dërguar pensionet në shtëpi.
- Pjesa më e madhe e nxënësve që jetojnë në qytet dhe në fshatrat afër qytetit e kanë ndjekur mesimin në distancë.
- Qytetarët tregojnë që në fillim ishin të frikësuar dhe mosbesues por i kanë respektuar masat dhe shpresojnë që ekonomia të rimëkëmbet sa më parë.

Analizë e gjetjeve

Raportim bazuar në informacionet e Bashkisë Pogradec

Ky raportim është bazuar në përgjigjet që Bashkia Pogradec i ka dhënë pyetësorit të dërguar në datë 7.4.2020. Bashkia Pogradec iu përgjigj pyetësorit brenda afatit kohor të përcaktuar nga ligji.

- Sipas të dhënave nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Pogradec janë 4498 persona që trajtohen me ndihmë ekonomike. Nuk kemi informacione për ndarjen gjinore të kësaj kategorie por sipas informacioneve të marra për këtë kategori shikohet një rritje me 148 familje që kanë përfituar ndihmë ekonomike krahasuar me muajin Mars të vitit paraardhës. Sipas të dhënave 532 familje janë në Pogradec Qytet, 891 familje janë në Buçimas, 850 janë në Çërravë, 365 familje janë në Dardhas, 639 familje janë në Udënisht, 563 familje janë në Proptisht, 354 familje janë në Trebinjë dhe 304 familje janë në Velçan.

Tabela 1

| Njësia Administrative | Numri i Familjeve përfituese |
|-----------------------|------------------------------|
| Pogradec Qytet | 532 |
| Buçimas | 891 |
| Çërravë | 850 |
| Dardhas | 365 |
| Udënisht | 639 |
| Proptisht | 563 |
| Trebinjë | 354 |
| Velçan | 304 |
| Totali | 4498 |

Nga totali i këtyre familjeve Bashkia Pogradec, përgjatë muajit Mars ka asistuar edhe me shërbime të tjera 318 familje që rezultojnë që nuk kanë asnjë të ardhur tjetër përveç ndihmës ekonomike, dhe 91 familje në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike si dhe ka asistuar me shërbime të ndryshme 311 familje në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike të cilët kanë mbi 5 anëtarë, 3 nga të cilët nën 18 vjeç. Këto të dhëna dhe disa informacione më shumë janë të shfaqura dhe në tabelën përmbledhëse nr. 8 dhe në figurën 5.

Tabela 2

| Përfituesit e ndihmës ekonomike dhe shërbimeve të ndryshme nga Bashkia | Mars 2020 |
|--|------------|
| Familje që përfitojnë ndihmën ekonomike dhe nuk kanë të ardhura të tjera | 318 |
| Familje që përfitojnë ndihmën ekonomike dhe kanë mbi 5 anëtarë, 3 nga të cilët nën 18 vjeç | 311 |
| Familje në nevojë që kanë përfituar ndihmën ekonomike nga fondet e Bashkisë | 91 |
| Total | 720 |


- Sipas të dhënave nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale janë 5031 persona që trajtohen me KEMP në Pogradec. Nga ky numër 2566 persona janë burra dhe 2465 janë gra. Nuk kemi informacion mbi statusin e tyre. Zonat ku jetojnë janë 2197 persona në Pogradec qendër 429 persona në Çërravë, 963 persona në Buçimas, 217 persona në Dardhas, 434 persona në Udenisht, 320 persona në Proptisht, 211 persona në Trebinjë, 192 persona në Velçan. Gjithashtu raportohet që nuk ka pasur penalizime për shkak të dorëzimeve jashtë afateve të dokumenteve apo shkaqe të tjera dhe pagesa ka vazhduar normalisht

Tabela 3

| Njësia Administrative | Numri i Familjeve përfituese |
|-----------------------|------------------------------|
| Pogradec Qytet | 2197 |
| Buçimas | 497 |
| Çërravë | 963 |
| Dardhas | 217 |
| Udenisht | 434 |
| Proptisht | 320 |
| Trebinjë | 211 |
| Velçan | 192 |
| Totali | 5031 |

Figura 1

TË DHËNAT GJINORE PËR PAK



Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Bashkia Pogradec

Nga nr. total prej 5031 personave përfitues të KEMP, Bashkia ka asistuar me shërbime të tjera personat me aftësi të kufizuar, të cilët nuk kanë familjarë në moshë aktive pune në njësinë administrative ku jetojnë. Janë asistuar me shërbime të ndryshme rreth 219 persona me AK, të cilat janë shpjeguar tek tabela 8 dhe figura 2.

- Raste të dhunës në familje përgjatë muajit Mars dhe Prill ka pasur vetem 3, ku prej të cilave 1 në Pogradec dhe 2 në zonat rurale. Sipas informacionit të marre të tre rastet kanë qenë nga gra. Nuk kemi informacion cilat zona specifike kanë qenë këto raste. Rastet e raportuara për këtë periudhë tregojnë një ulje prej 40% krahasuar me rastet e raportuara një vit më parë në këtë kohë.

Tabela 4

| Nr. Raportime të dhunës në familje | Burra | Gra | Jetojnë në zonë urbane/rurale |
|------------------------------------|-------|-----|----------------------------------|
| 3 | 0 | 3 | 1 pogradec dhe 2 në zonat rurale |

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Bashkia Pogradec

- Sipas të dhënave të raportuara nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale janë 5200 familje Rome dhe Egjiptiane në qytetin e Pogradecit, janë 300 familje të komunitetit egjiptian në Buçimas dhe 40 familje po të komunitetit egjiptian në Çërravë. Nuk kemi informacione të tjera për këtë target grup por sipas burimeve pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, këto komunitete po ndihmohen me pako ushqimore dhe një pjesë e tyre gjithashtu është dhe pjesë e ndihmës ekonomike.

Tabela 5

| Nr. i familjeve Rome e Egjiptiane | Njësia administrative |
|-----------------------------------|-----------------------|
| 5200 | Pogradec |
| 300 | Buçimas |
| 40 | Çërravë |

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Bashkia Pogradec

- Në qytetin e Pogradecit rezultojnë vetëm 7 jetimë. Nga ky numër, 5 janë burra dhe 2 gra. Zonat ku jetojnë janë Pogradec dhe njësia administrative Buçimas, Çërravë, Udënisht.

Tabela 6

| Nr i personave jetime | Burra | Gra | Njesia Administrative |
|-----------------------|-------|-----|-----------------------|
| 2 | 0 | 2 | Pogradec qendër |
| 1 | 1 | 0 | Buçimas |
| 2 | 2 | 0 | Çërravë |
| 2 | 2 | 2 | Udënisht |

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Bashkia Pogradec

- Sipas të dhënave nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale janë vetëm 2 vajza-nëna në Pogradec. Nuk kemi informacion për trajtim të veçantë apo ndihmë specifike kundrejt tyre. Zona ku jetojnë është Pogradec qendër.

Tabela 7

| Vajza nëna | Jetojnë në zonë urbane/rurale | Njësia administrative |
|------------|-------------------------------|-----------------------|
| 2 | Pogradec | Pogradec qender |

Burimi: Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Bashkia Pogradec

- Bashkia e Pogradec ka qenë e angazhur maksimalisht në identifikimin e rasteve të familjeve ose personave në moshën e tretë duke ju shërbyer në çdo rast të kërkuar prej tyre. Po ashtu raportohet që janë organizuar grupet e terrenit që të shërbenin e mbështësnin këtë grupmoshë duke hartuar grafikë planifikimi për të komunikuar ose shërbyer. Janë asistuar 1512 pensionistë dhe nga të cilat janë identifikuar dhe 128 pensionistë që jetojnë vetëm dhe që familjarët ju jetojnë jashtë. Jane ndihmuar me ndihma ushqimore, vizita mjekësore dhe shërbime të tjera sipas nevojave. Nuk kemi informacion për ndarjen gjinore por sipas burimeve dimë që kanë qenë me projeksion me të madh burra.
- Bashkia Pogradec ka ndihmuar gjithashtu dhe me disa lloje shërbimesh që janë përcaktuar si mëposhtë:
 1. Shërbim ushqimor falas që konsiston në pakot me ushqime që janë shpërndarë në familje nga fondet e Bashkisë apo nëpërmjet bashkëpunimit me donatorë privat, fondacione.
 2. Shërbim ushqimor me pagesë që konsiston në ndihmen e familjeve për të kryer pazaret nëpërmjet grupeve vullnetare ose duke paguar transportin privat (taksi) në rastet e nevojshme.
 3. Shërbim jo ushqimor falas konsiston në mbulimin e shpenzimit të dritave dhe të ujit për familjet.
 4. Shërbim jo ushqimor me pagesë është ndihma për të paguar dritat, ujin apo nevoja të tjera që kanë pasur familjet.
 5. Shërbime mjekësore të rimbursueshme, pajisja me mjekimet sipas listave të shtetit për ilaçet e rimbursueshme.
 6. Shërbime mjekësore me pagesë, ndihma nga grupet vullnetare për blerjen e ilaçeve apo vizita mjekësore që janë kryer duke respektuar rregullat.

Këto shërbime janë ofruar përgjatë muajit Mars pranë;

- a) 318 familjeve që përfitojnë ndihmën ekonomike dhe nuk kanë të ardhura të tjera
- b) 91 familjeve që përfitojnë ndihmën ekonomike nga Fondi i Bashkisë me vendim të Këshillit Bashkiak
- c) 311 familjeve që përfitojnë ndihmën ekonomike dhe që kanë mbi 5 anëtarë, 3 nga të cilët nën 18 vjeç
- d) 134 të pastrehë
- e) 1512 pensionistë të cilët nuk kanë familjarë në moshë aktive pune në njësinë administrative ku jetojnë
- f) 8 familje që kanë humbur banesën për shkak të tërmetit
- g) 219 personave me aftësi të kufizuar, të cilët nuk kanë familjarë në moshë aktive pune në njësinë administrative ku jetojnë

Tabela 8

| Përfituesit e shërbimeve të ndryshme sipas kategorive/nënkategorive | Mars 2020 |
|--|-------------|
| Familje që përfitojnë ndihmën ekonomike dhe nuk kanë të ardhura të tjera | 318 |
| Familje që përfitojnë ndihmën ekonomike dhe kanë mbi 5 anëtarë, 3 nga të cilët nën 18 vjeç | 311 |
| Familje në nevojë që kanë përfituar ndihmën ekonomike nga fondet e Bashkisë | 91 |
| Të pastrehë | 134 |
| Pensionistë | 1512 |
| Pa banesë për shkak të tërmetit | 8 |
| PAK | 219 |
| Total | 2593 |

Më poshtë janë shfaqur disa informacione mbi ndihmat e Bashkisë për llojin a) ushqimore falas c) ushqimore me pagesë d) jo ushqimore falas e) jo ushqimore me pagesë. Mbi shërbimin mjekësor të rimbursueshëm dhe me pagesë, Bashkia Pogradec ka mbajtur të dhëna vetëm javën e parë të Marsit pas kësaj këto të dhëna janë mbajtur nga insitucionet përgjegjëse për shëndetësinë.

Nr. PAK




Figura 2. Ndihma ndaj personave me aftësi të kufizuara të cilët nuk kanë familjare në moshë aktive për punësim.

Asistimi i pensionistëve




Figura 3. Ndhimja ndaj pensionistëve që nuk kanë një familjar në moshë aktive për punësim

Asistimi me shërbime të ndryshme nga Bashkia




Figura 4. Ndhimja ndaj personave të pastrehë dhe familjeve që kanë humbur banesën për shkak të tërmetit.

NR i familjeve që kanë marrë shërbime nga Bashkia





Figura 5. Sipas të dhënave të raportuara nga Bashkia për muajin Mars, nga familjet që nuk kanë të ardhura të tjera përveç ndihmës ekonomike janë ndihmuar me shërbim ushqimor falas 183 familje, me shërbim ushqimor me pagesë 45 familje me jo ushqimore falas 41 familje dhe me jo ushqimore me pagesë 25 familje.

Gjetje nga intervistat cilësore

Gjatë muajit Prill 2020, janë kryer një sërë intervistash cilësore nga stafi i RIAS dhe BRKP me banorë të zonave rurale dhe urbane të Bashkisë Pogradec. Pyetjet kishin të bënin në lidhje me situatën ku banorët gjendeshin pas mbylljes për shkak të pandemisë COVID-19 dhe çfarë kishin përfituar nga zbatimi i masave të qeverisë Shqiptare dhe nga Bashkia Pogradec.

Figura 1. Intervistat me qytetarë

Intervistat sipas shtresave të qytetarëve



Gjatë periudhës kohore 5-30 Prill u intervistuan më shumë se 60 individë dhe subjekte tregtare në 7 njësitë administrative të bashkisë Pogradec, përfshirë këtu edhe njësitë administrative të zonave rurale sipas target grupeve më lart.

- Përsa u përket pensionistëve, në përgjithësi pensionet ju shkojnë në shtëpi dhe tregojnë që Bashkia Pogradec ka vendosur një nr. tel në dispozicion (për çdo njësi administrative) për ti dërguar pensionet në shtëpi. Pensionet dorëzohen nëpërmjet ndihmës së familjareve ose nëpërmjet grupeve vullnetare që Bashkia ka vënë në dispozicion. Gjithashtu disa nga pensionistet konfirmojnë që kanë pasur ndihmë edhe për blerje medikamentesh, pazare dhe asistime të tjera nga grupet vullnetare.

"Bashkia ka venë një nr. tel dhe une e provova për prindërit e mi dhe funksionoi. Pensioni erdhi dy ditë me vonesë por që ne e mirëkuptojme nga situata".

(qytetare)

- Nga hulumtimet e kryera dhe nga intervistat e drejtpërdrejta në Komunitetin Rom & Egjiptian shikohet që të gjithë familjet e intervistuar nga ky komunitet kanë marrë pako ushqimore. Ato shprehen të kënaqur përveç disa rasteve sporadike ku shprehen: **"që duhet të kishte pasur më shume vaj"**.
- Familjet që kanë marrë ndihmë ekonomike shprehen që kanë pasur dyfishim të kësaj pagese për muaji Mars dhe gjithashtu konfirmojnë që kanë marrë ndihmë për pazaret, blerje medikamentesh kur kanë pasur nevojë nga grupet vullnetare të ngritura nga Bashkia.
- Gratë punonjëse të fasonerive tregojnë që puna vazhdon normalisht por që kanë ndryshuar rregullat dhe procedurat. Pjesa më e madhe e tyre shprehet që kanë qenë të frikësuar për shëndetin e tyre dhe të familjarëve të tyre por nuk mund të linin punën pasi shpesh është i vetmi burim të ardhurash.

"Puna ka vazhduar normalisht dhe paga nuk na është mohuar por kam qenë shumë e frikësuar dhe ka pasur ditë që nuk doja të shkoja në punë. Shyqyr zotit deri sot ska pasur ndonjë rast të ne"

(punonjëse fasonerie)

- Personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre raportojnë që nuk kanë hasur pengesa në marrjen e pagesës së aftësive të kufizuar dhe nuk ka pasur as ulje as ngritje të shumës. Në 2 raste nga të intervistuarit konfirmohet që pagesa ka vazhduar dhe nuk është pezulluar për çështje afatesh apo për rinovim të dokumentacionit.
- Një kategori tjetër që u pyet përmes intervistave ishin nxënësit e shkollës 9 -vjeçare dhe të mesme, për të parë se çfarë ndodh me mësimin e tyre online.

Ato tregojnë që mësuesit jua dergojnë mësimet me video në whats app, një nr. i vogël i mësuesve e zhvillon me platforma të tjerë si ZOOM apo Google Meet. Nëpermjet TV nuk e ndjekin pasi temat nuk korrespondojnë me programin mësimor apo vitin që ata janë. Nxënësit shprehen se në këtë periudhë janë shumë herë më të ngarkuar pasi mundohen ta kuptojnë vet mësimin dhe më pas të zgjidhin vet të gjitha ushtrimet.

Unë dua që të kthehem sa më parë në shkollë pasi une e kam shumë të vështirë të ndjek mësimet nga celulari. Kam shokët që i telefonoj dhe më ndihmojnë dhe mësuesja është shumë e mirë por shpesh kam dhimbje koke dhe vështirësi të bëj detyrat.

(nxënës i shkollës 9 vjeçare)

- Grupi i punës pati vështirësi për të marrë intervista nga subjektet tregtare pasi nuk aksesonin dot administratorët për shkak të kohës dhe ngarkesës që këto të fundit kishin. Nga 5 intervistat e dhëna, të gjithë konfirmojnë që kanë aplikuar për pagën e luftës dhe e kanë marrë atë për muajin Mars.

Situata e biznesit

Për shkak të kohës së shkurtër dhe pamundësisë për të takuar shumë përfaqësues nga biznesi nuk kemi një informacion shumë të plotë mbi biznesin.

Sipas monitorimit të bërë për raportin kemi nxjerrë disa pika që mendojmë se janë të rëndësishme për sektorin:

1. Bashkia Pogradec ka zëruar tarifat vendore për muajin Prill si dhe ka shtyrë pagesat për muajt e tjerë deri në qershor.
"Me propozim të kryetarit të bashkisë, Këshilli Bashkiak miratoi projektvendimin për zerimin e tarifave vendore për muajin prill, për të gjitha bizneset e mbyllura për shkak të situatës së Covid19. Këtu përfitojnë të gjitha bizneset të cilat janë urdhëruar të mbyllen nga udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë, në qytet dhe njësitë administrative.
Biznesi i mbyllur nuk do të paguajë asnjë tarifë vendore për muajin prill, ndërkohë që është përjashtuar edhe nga taksa e hapësirës publike për muajin mars dhe prill. Gjithashtu është vendosur që pagesa e tarifave të rinisë pas muajit qershor për këto biznese."
2. Kryetari i Bashkisë ka njoftuar që "Për periudhën e sezonit veror do të bëjmë të mundur uljen e tarifave vendore për bizneset në mënyrë që ato të kenë mundësi të rimarrin veten pas pasojave që është duke lënë situata e virusit."
3. Në fasoneritë e Pogradecit puna vijon normalisht. Jane vendosur rregulla dhe masa që duhen ndjekur rigorozisht për vazhdimësinë normale të punës.
4. Në datën 27 prill nga ora 5.00-17.30 janë lejuar të hapen këto lloje biznesesh apo shërbimesh:
 - shërbim taxi,
 - dyqanet e veshjeve tekstile,
 - dyqane që tregtojnë mobilie, artikuj shtëpiake, pajisje të ndriçimit,
 - dyqanet e luleve, bimeve, kafsheve,
 - dyqanet e pajisjeve sportive, pajisjeve elektronike
5. Ka informacion që shumë biznese që kanë aplikuar për pagën e luftës dhe e kanë marrë atë.

Rekomandime

- Bashkia Pogradec duhet të krijojë një database të dhënash sipas çdo kategorie në nevojë dhe gjithashtu të aktivizojë punonjësit e tij për të regjistruar personat nga grupet vulnerable apo kategori të tjera që nuk rezultojnë në asnjë database;
- Bashkia Pogradec në kuader të transparence duhet të updatoje vendimet e Këshillit Bashkiak ne website të tyre dhe pranë kanaleve të tjera si vendime.al;
- Mbledhja në kohë reale e të dhënave dhe ndarja e tyre gjinore është një domosdoshmëri që bashkia Pogradec duhet ta ketë në vëmendje dhe jo vetëm gjatë situatës pandemike;
- Ri-shikimi i fondeve apo lobimi pranë qeverisë për buxhete të cilat mund të vijnë në ndihmë të kategorive të cilat nuk janë parashikuara në VKM-të e mëparshme për ndihmë të shtresave në nevojë;
- Një vëmendje më e shtuar për kategorinë e komuniteteve Rome & Egjiptiane, sidomos për ato familje të cilat nuk kanë asnjë mundësi jetese përveç mbledhjes së plastikës dhe aluminit;
- Lobimi në qeverinë qendrore për përfshirjen në VKM-të respektive të ndihmës edhe për target grupet si të rinjtë apo vajzat nëna;
- Bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm që edhe fëmijët e zonave rurale dhe ato të familjeve në nevojë të mund të pajisen me telefona smart, të cilat mund t'ua lehtësojnë mësimnxënien.
- Forcimi i MKR-së dhe drejtimi i tyre për të qenë sa më aktivë dhe funksionalë në mbështetje të viktimave të dhunës në familje dhe asaj gjinore.
- Forcimi i bashkëpunimit me efektiv të insitucioneve të ndërvarësisë për një punë më efektive dhe transparente.

Vendimet e Këshillit Bashkiak

Këshilli Bashkiak Pogradec që nga periudha e shpalljes së Pandemisë COVID-19 dhe pas infektiveve të para në Shqipëri në datë 9 Mars është mbledhur 4 here, ku dhe janë diskutuar çështjet dhe janë marrë vendimet si më poshtë:

- 1. Mbledhja e datës 25.03.2020** Kjo mbledhje në kushte të jashtëzakonshme ishte e para që u realizua online (me video call). Të pranishëm ishin 17 nga 31 anëtare të Këshillit Bashkiak Pogradec. Kryetari dhe sekretari i Këshillit Bashkiak e realizuan këtë mbledhje nga salla e Këshillit Bashkiak. Kjo mbledhje kishte rend dite një Projekt-Vendim për "Dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për periudhën 1-29 Shkurt 2020". Sipas relacionit shpjegues bashkëngjitur në këtë projekt-vendim, përfitojnë ndihmë ekonomike 88 familje nga i gjithë territori i Bashkisë së Pogradecit. Ky projekt-vendim mori 17 vota PRO.

Në fund të mbledhjes, Kryetari i Këshillit ju kërkoi anëtarëve, sipas zonës që ata përfaqësojnë në Këshillin Bashkiak, të evidentojnë familjet që kanë nevojë në këto ditë, për ti ndihmuar me produkte të shportës ushqimore, nga fondi i krijuar nga vetë kontributet e antarëve të Këshillit Bashkiak.¹

- 2. Mbledhje e date 03.04.2020**, u realizua serisht online (me video call), ku të pranishëm ishin 18 nga 31 anëtare të Këshillit Bashkiak Pogradec, 12 femra dhe 6 meshkuj. Kryetari dhe sekretari i Këshillit Bashkiak e realizuan këtë mbledhje nga salla e Këshillit Bashkiak. Kjo ishte mbledhje jashtërradhe për një projekt-vendim që ka ndikim të drejtëpërdrejtë dhe të menjëhershëm në situatën në të cilën ndodhemi, nën COVID-19. Projekt-Vendimin për Amendimin e Kontratës" Vazhdim i Shërbimit të Pastrimit, grumbullimit dhe largimit të mbeturinave të qytetit Pogradec dhe Njësive Administrative për nevojat e fillim vitit", propozohet amendimi i kontratës së pastrimit, me dt. 25.02.2020, për një periudhe minimalisht 3 mujore. Kjo lindi si një nevojë e domosdoshme pasi në zërat e preventivit të kontratës nuk përfshihej shërbimi i dezinfektimit të ambjenteve dhe godinave në territorin e Bashkisë së Pogradecit.²

- 3. Mbledhje e dates 07.04.2020**, edhe kjo mbledhje u realizua online (me video call), ku të pranishëm ishin 18 nga 31 anëtare të Këshillit Bashkiak Pogradec, 11 femra dhe 7 meshkuj. Kryetari dhe sekretari i Këshillit Bashkiak e realizuan këtë mbledhje nga salla e Këshillit Bashkiak.

Kjo u përcaktuar gjithashtu si mbledhje jashtë rradhe për një projekt-vendim që ka ndikim të drejtëpërdrejtë dhe të menjëhershëm në bizneset që janë pezulluar për shkak të situatës në të cilën ndodhemi, nën COVID-19.

¹ Mbledhja është e regjistruar me video dhe audio, dhe e shpërndarë në median lokale (Sot7, RTSH Korçë), Ora News si dhe në faqen e Facebook të Këshillit Bashkiak Pogradec:

https://www.facebook.com/K%C3%ABshilli-Bashkiak-Pogradec-110757260459936/?epa=SEARCH_BOX
<https://www.youtube.com/watch?v=NbucUPGS5qo> <https://www.facebook.com/111843260451349/videos/346621162959306/?v=346621162959306>

² Kjo mbledhje është regjistruar nga sekretari i Këshillit Bashkiak dhe është shpërndarë vetëm me anëtarët e Këshillit Bashkiak.

U votua dhe u vendosen:

- a) Lehtësim fiskal ndaj biznesit në kuadër të situatës së krijuar ndaj COVID-19, subjektet të cilat janë mbyllur me urdhër të Ministrisë së Shëndetësisë nr.164 datë 12.03.2020, për muajin Prill 2020, do të taksohen me 0 lekë për tarifatat vendore, kurse për muajt e ardhshëm do të merren vendime të tjera në kohë reale nga ana e Këshillit Bashkiak.
- b) Gjithashtu, për subjektet të cilat do të paguajnë tarifatat vendore, afati i shlyerjes së tyre do të bëhet në katër këste, duke filluar që nga muaji Qershor 2020. ³

4. Mbledhje e datës 29.04.2020, sërish u mbajt online dhe u morën keto vendime:⁴

- a) Dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për periudhën 1-31 Mars 2020" për 25 familje
- b) Projekt-vendim për ndryshimet në buxhetin e Bashkisë, për tu kaluar një fond 20,000,000 lekë në rikonstruksion të banesave të familjet të varfëra
- c) Shtyrjen e afatave për aplikimet e kredive të buta në Bashki.
- d) Lista e fondit të tokave kullosore që jepen me qera për sasi tokash dhe taksa që duhet ti paguajnë Bashkisë për këtë.
- e) Miratimi në parim i marrëveshjes Fondi Shqiptar i Zhvillimit për projektin e rikonstruksionit të rrugës Pogradec- Tushemisht
- f) Projekt-vendim për miratin e rezolutes për marrjen e masave të vecanta për shkak të situatës së krijuar nga Covid 19. Kjo rezolutë ishte për bashkëpunimin e institucioneve dhe raportimet për dhunën në familje.

Nuk pati kundërshtime dhe u miratuan unanim të gjitha pikat.

³ Kjo mbledhje u regjistrua nga Sekretari i Këshillit Bashkiak dhe ju shpërnda të gjithë anëtarëve, ndërsa për qytetarët u bë njoftimi nëpërmjet televizionit lokal.

https://www.sot7tv.al/?p=1267&fbclid=IwAR3_S1Cilcbb0ifoR_vhi1IGYbb_bsrWghnDb_nh6Z9H58UPkyu5DzuWnEU

⁴ Mbledhja u regjistrua dhe u shfaq live në faqen zyrtare të facebookut të Këshillit Bashkiak Pogradec <https://www.facebook.com/110757260459936/videos/292815715046268/>

Pyetësori që i është dërguar bashkisë

Nr.Prot. 1

Pogradec, 7.04.2020

KËRKESË PËR INFORMACION

Bazuar në Ligjin Nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit"

Drejtuar: Z. Ilir Xhakolli, Kryetar i Bashkisë Pogradec

Lënda: Kërkesë për Informacion në lidhje me masat e marra për popullsinë në zonat rurale dhe urbane të Bashkisë Pogradec në situatën e pandemisë COVID- 19.

I nderuar Z. Xhakolli, Kryetar,

Uroj të jeni mirë me shëndet e punë. Ju ndjekim vazhdimisht në punën tuaj të përditshme dhe ju përgëzojmë për gjithshçka jeni duke bërë për Bashkinë tonë në përgjithësi e në këtë periudhë të vështirë të pandemisë për shkak të COVID-19.

Duke marrë parasysh situatën aspak të zakonitë që bota në përgjithësi dhe Shqipëria në veçanti po kalon prej pandemisë COVID-19, organizatat e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP), të krijuar gjatë zgjedhjeve Parlamentare 2013 janë duke monitoruar situatën e qasjes së pushtetit vendor pranë komunitetit në 9 bashki të vendit⁵ si dhe mbledhjet e Këshillave Bashkiakë dhe vendimet e tyre.

Bashkia e Pogradecit, monitorohet nga organizata RIAS në bashkëpunim me Bordin Rinor Këshillimor Pogradec në të cilën ju keni firmosur marrëveshjen e Bashkëpunimit në 16 dhjetor 2019.

Me masat e marra nga qeveria shqiptare në lidhje me përballimin sa më të mirë të kësaj situatë, një zë të veçantë ka edhe mbështetja për komunitetin dhe grupet në nevojë, qoftë kjo mbështetje ekonomiko - financiare, shëndetësore apo sociale. Në këtë kuadër, ne do të përgatisim në fillim të muajit maj 2020 një raport i cili do të përfshijë hapat e marra nga bashkia për zbatimin e vendimeve të Qeverisë Shqiptare dhe rekomandime nga ne për shërbimet e ofruara.

Bazuar në këto masa dhe në zbatimin e tyre pranë komunitetit të Bashkisë Pogradec, do ju luteshim të na informoni bazuar në pyetjet e mëposhtme:

- Ju lutem na vini në dispozicion vendimet e Këshillit Bashkiak pas datës 9 Mars 2020.
- Sa familje në zonat rurale e urbane janë trajtuar me Ndihmë Ekonomike në Bashkinë Pogradec gjatë muajit shkurt? A ka patur ndryshime në shtimin e rasteve të familjeve me ndihmë ekonomike pas datës 9 Mars dhe sa është numri i përfituesve? A e keni informacionin të ndarë sipas gjinisë që familjet dhe individët e trajtuar nga bashkia juaj, janë identifikuar në territor me probleme të tjera si p.sh. familje me persona me aftësi të kufizuar, fëmijë me autizëm apo tjetër.

5 Bashkitë që po monitorohen janë: Tiranë, Vlorë, Fier, Durrës, Shkodër, Kukës, Pukë, Pogradec, Kamëz.

- Sa persona, të ndarë sipas gjinisë dhe zonës rurale apo urbane trajtohen me pagesën e paaftësisë për punë (KEMP) të dalë nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMACP) të invalidëve. A ka patur shtim të tyre pas datën 9 Mars 2020? Në rastet kur kohëzgjatja e KMACP ka përfunduar në këtë periudhë dhe kërkon ribërjen e dokumentave nga e para si është vepruar, a ka patur penalizime në vazhdimin e dhënies së pagesave për këtë kategori? A e keni informacionin të ndarë sipas gjinisë dhe moshës së tyre, nëse po sa meshkuj e femra janë?
- Sa familje në zonat rurale e urbane, përfitojnë përfitim bonus qeraje? A është shtuar numri i tyre pas datës 9 Mars 2020?
- A keni patur e trajtuar raste të dhunës në familje gjatë muajit mars dhe këtë fillim prilli 2020? Nëse po sa raste keni patur? Si është trendi i kësaj periudhe krahasuar me një vit më parë?
- Cilat janë masat e marra për komunitetin Rom dhe Egjiptian pas datës 9 Mars 2020? Sa është numri i familjeve Rome e Egjiptiane, ku janë vendosur ata në Bashkinë Pogradec (zone e caktuar) dhe kush janë përfitimet që ata marrin nga Bashkia.
- Pas vendosjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore nga Qeveria Shqiptare shoqëruar me izolim të detyrueshëm, a keni identifikuar persona të moshës së tretë që jetojnë vetëm dhe i kanë fëmijët jashtë vendit? Sa është numri i tyre i ndarë sipas gjinisë? Cilat janë masat që ka marrë Bashkia Pogradec për këtë kategori?
- Sa është numri i individëve me statusin e jetimit të ndarë sipas gjinisë, që jetojnë në Bashkinë Pogradec? A po marrin trajtim të veçantë nga Bashkia? Nëse po, cilat janë masat e ndërmarra?
- Sa vajza – nëna ka në Bashkinë Pogradec? Në cilat njësi administrative janë të vendosura? A po marrin trajtim të veçantë nga Bashkia Pogradec? Nëse Po, cilat janë masat e ndërmarra?
- Gjatë identifikimit në territor me grupet e punës a keni ofruar ndihmë për individët e papunë, sa nga këta janë burra dhe sa gra dhe cila është ndihma e ofruar? Keni informacion sa është shtuar numri i tyre pas vendosjes së izolimit/vetëkarantimit prej situatës COVID-19. A keni bërë një projeksion të papunësisë?
- Në sa familje keni dërguar ndihma dhe në cilat zona e fshatra? Sa është rritur numri i familjeve që kanë nevojë për ndihma pas datës 9 Mars, 2020. Çfarë përmbajnë këto ndihma? Sa është sasia normale për një familje dhe si dhe sa here bëhet shpërndarja e tyre?
- A ka patur ndryshim të buxhetit të Bashkisë Pogradec pas vendosjes së masave të marra për situatën COVID-19. Nëse jo, si po përballohet kjo situatë nga Bashkia dhe nëse po si dhe ku janë reflektuar këto ndryshime?
- Referuar kategorisë së të rinjve, a ka ndonjë masë ose kërkesë specifike të ndërmarrë nga Bashkia Pogradec? A ka të rinj të rikthyer nga jashtë Shqipërisë së fundmi pas datës 9 Mars? Çfarë shërbimi po ju ofrohet atyre?
- Cilat janë mjetet dhe mënyrat që komunikoni me qytetarët në njësi administrative dhe në qytet për shërbimet që ofroni gjatë periudhës së izolimit/vetëkarantimit të detyrueshëm?

Ne kemi përgatitur disa tabela të vendosura në aneks të kësaj letre që mund të ndihmojë për mbledhjen e informacionit (nga pyetja 2-11). Për sa më sipër, sipas kategorive do ju luteshim që të na dërgoni statistikat përkatëse dhe mënyrën e funksionimit të ndërmarrjes së masave në këtë kuadër (shtoni rreshta në rastet kur kërkohet informacion sipas kategorive të moshës dhe gjinisë). Kurse pyetjet e tjera nuk janë të parashtruara në Aneks sepse kërkojnë shtjellim dhe bashkëngjijtë dokumentacioni (specifikisht pyetja 1, 12, 13 dhe 14)

Gjithashtu, donim t'ju vinim në dijeni se përpara zgjedhjeve lokale të Qershorit 2019, organizata jonë në bashkëpunim me Bordin Rinor Këshillimor Pogradec dhe ju, keni nënshkruar Kontratën Sociale, e cila përmban disa prioritete të cilat janë informuar në aktivitetet tona nga qytetarët e Pogradecit. Kjo kontratë është rifreskuar edhe në takimin e zhvilluar në datën 16 Dhjetor 2019 me Bordin Rinor Këshillimor Pogradec ku është firmosur edhe Marrëveshja e Bashkëpunimit në kuadër të projektit POP 2019. Ne jemi të bindur që ju keni punuar gjatë 2019 dhe po punoni në 2020 për ti realizuar ato, megjithë fatkeqësitë e mëdha natyrore si COVID-19. Në lidhje me Kontratën Sociale dhe zbatimin e saj ne do të bëjmë një tjetër kërkesë në muajin qershor 2020.

Informacioni i kërkuar më sipër do të ishte një udhëzues edhe për ne si organizatë për të parë mundësinë se si mund të ofrohemi për ndihmë në këto kohë të vështira dhe të pazakonta për të gjithë.

Edhe pse situata është e vështirë, duhet të kemi parasysh të gjithë që komuniteti e ka të nevojshëm informacionin e saktë, sjelljen me dinjitet kundrejt tyre dhe mbështetjen ekonomiko – sociale.

Duke ju uruar punë të mbarë në menaxhimin dhe përballimin e kësaj fatkeqësie natyre, mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj,

Sinqerisht,

**Mirela JUKA
Drejtore Ekzekutive
Organizata RIAS**